



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Procesverbal i mbajtur më 17 prill 2024, në mbledhjen e XXII-të (njëzetetre)-e jashtëzakonshme, mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:13

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; *(Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; kurse mungoi Mrika Thaçi, bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.*

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishme ishte edhe; *Adelina Stublla Drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS*

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, theksoi, kjo është një mbledhje e jashtëzakonshme e cila është thirr me kërkesë të Kryetarit të Komunës dhe janë 2 pika të rendit të ditës, andaj besoj se të gjithë pajtohemi që të punohet me këtë rend të ditës sepse nuk kemi mundësi as të heqim e as të shtojmë ndonjë pikë të rendit të ditës, mirëpo vetëm të fillohet me punë.

- 1. Propozim vendimi për shfuqizimin e Vendimit nr.prot.01-462/01-0075934/19 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më datë 23.09.2019.**

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, në këët pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me propozim vendimin për shfuqizimin e Vendimit nr.prot.01-462/01-0075934/19 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më datë 23.09.2019. Pra kërkesa është që ky vendim i Kuvendit i miratuar më 23.09.2019 të shfuqizohet, andaj për më shumë fjalën i'a jap drejtoreshës së DSHMS n'domenin e të cilës bie kjo çështje.

znj. Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, duke paraqitur këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, në emër të Kryetarit të Komunës si iniciues i këtyre pikave të rendit të ditës, meqë Kryetari është në një takim atëherë unë e elaboroj çështjen e këtyre pikave të rendit të ditës dhe njëkohësisht t'ia rekomandojmë Kuvendit të Komunës.

Siç e dimë më datë 19.03.2024 është marrë vendim për shfuqizimin e vendimit për themelimin e Spitalit të përgjithshëm në Komunën e Podujevës të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë më datë 27.10.2016, kurse më datën 25.03.2024 Ministria e Shëndetësisë ka marrë vendim për themelimin e Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës, dhe krejt kjo si çështje e mungesës së resurseve humane në nivel të përgjithshëm, kështu që ne do ta bëjmë Poliklinikën për shërbime specialistike që janë të nevojshme për pacientët që shpenzojnë nëpër ordianca private dhe mbi të gjitha vlen të theksohet çështja se në kuadër të shërbimeve specialistike do ta kemi edhe shërbimin e Hemodializës gjë që do të jetë e mirëseardhur për 30 pacientët duke përfshirë edhe një numër të konsiderueshëm që nuk janë banorë rezident por që vijnë për pushime këtu dhe që pastaj duhet t'i bartim ne. Pra do të kryhen shërbimet specialistike, do ta bëjmë Hemodializën për pacientët të cilët maltreohen në rrugën Podujevë - Prishtinë si dhe fshatrat përreth, prandaj nga Ju presim që t'i rekomandohet Kuvendit për miratim.

z. Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim propozim vendimin për shfuqizimin e vendimit të datës 23.09.2019, në mënyrë që t'i hapet rrugë ndërtimit apo funksionalizmin e Poliklinikës së përgjithshme me të gjitha ato drejtime që janë të përfshira, e që njërën prej tyre e përmendi drejtoresha e DSHMS që bëhet fjalë për shërbimin e Hemodializës për të cilën qytetarët pacientë shkojnë në Prishtinë për t'i kryer funksionet, ndihmat apo intervenimet e ndryshme por që do të jetë shumë më mirë që këto t'i kryejnë në qytetin e tyre.

z. Naim Çunaku, theksoi, vërtetë nuk e kam menduar ndonjëherë që do të vijmë në një situatë që të vendosim për një shkurtim të një shërbimi shëndetësorë siç e kemi pasur një vendim të nxjerrë nga niveli qendrorë, e që nuk ka të bëjë me neve, por të gjitha ato që i potencuan parafolësit duke pas parasysh distancën gjeografike Prishtinë - Podujevë, vërtetë është një shërbim i largët për qytetarët / pacientët, dhe krejt kjo është menduar që me hapjen e perspektivës së ndërtimit dhe funksionalizimit të Spitalit të Përgjithshëm, atë shërbim shëndetësorë jetik për qytetarët e Komunës së Podujevës që ta kryejnë në Komunën e tyre.

Sigurisht që do të doja që Spitalit të përgjithshëm t'i shtohet edhe Ambulanta Specialistike dhe ta kemi të kompletuar për qytetarët, por jemi në një situatë çfarë jemi dhe vërtetë për mua kjo situatë është aspak e lakmueshme, aspak në shërbim të interesave të qytetarëve dhe si të tillë ne normale që nuk do të marrim pjesë në votim rreth kësaj pike ngase nuk kemi dorë të ngritim nalt për një shkurtim esencial shëndetësorë për qytetarët e Komunës së Podujevës.

z. Bashkim Sylja, theksoi, fillimisht më vie keq që po i bie drejtoreshës së DSHMS të merret me këtë çështje sepse ky është një vendim i Ministrisë së Shëndetësisë, konkretisht unë jam shumë i habitur me arsyetim se kjo po bëhet për shkak të mungesës së resurseve humane, pra që është anuluar ai vendim.

Unë jam kundër kësaj dhe shpresoj se shumica e asambleistëve janë kundër sepse ne të gjithë e dimë se sa ka nevojë Komuna e Podujevës për Spital të Përgjithshëm për të cilin ashtu siç e përmendi drejtoresha e DSHMS themelimi i të cilit është iniciuar në vitin 2016 kurse tani jemi në vitin 2024, madje ka qenë premtim elektoral i LDK-së dhe i LVV-së në tri palë zgjedhje që do ta bëjnë Spitalin e Përgjithshëm në Komunën e Podujevës, kështu që unë mendoj se më mirë do të ishte të pritej edhe 1 vit në mënyrë që të mos i'u privohet kjo e drejtë e qytetarëve të Komunës së Podujevës të mos kenë Spital të Përgjithshëm, e them këtë sepse në rast se anulohet ai vendim, veç Zoti e din kur do të iniciohet një themelim i një Spitali të përgjithshëm në Komunën e Podujevës.

Po tentohet këtu që të zëvendësohet një Spital i Përgjithshëm me një Poliklinikë Specialistike për të cilën unë mendoj se nuk i plotëson nevojat dhe kërkesat e qytetarëve sepse Komuna e Podujevës është me rreth 90000 banorë dhe një Komunë me territorin pothuajse më të madh në territorin e Kosovës, kështu që qytetarët e Komunës së Podujevës shërbimet e tyre shëndetësore i kryejnë në Vushtrri sepse edhe kjo Komunë ka Spital të Përgjithshëm, pastaj edhe Mitrovica ka Spital të Përgjithshëm, dhe kostoja e atyre shpenzimeve është shumë e lartë e që shumica e tyre përveç Prishtinës shkojnë edhe nëpër ordianca private, kështu që sërish e them se unë mendoj që më mirë është të pritet edhe 1 vit.

Përndryshe Ministria e Shëndetësisë e ka për obligim të gjejë staf ashtu sikurse po gjen mjek dhe staf tjetër shëndetësorë për Spitalet në Vushtrri, Mitrovicë dhe Spitale tjera të përgjithshme, edhe në Komunën e Podujevës ka mund të gjejë zgjidhje, mirëpo është vendim i tyre dhe jo vetëm që jam kundër po mendoj se është gabim të shtyhet përpara ky proces.

z.Naim Çunaku, theksoi, atë që e potencoj edhe kolegu z.Bashkim Sylja që shkaku i mungesës së resurseve humane, sigurisht që e dim se punëtorët dhe staf shëndetësorë kanë qenë të pranuar me konkurs për Spitalin e Podujevës por që janë të sistemuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës deri sa të krijohen mundësitë për t'i sistemuar dhe shërbyer në Spitalin e Përgjithshëm në Podujevë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, mund ta hedhin në votim propozim vendimin për shfuqizimin e Vendimit nr.prot.01-462/01-0075934/19 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më datë 23.09.2019, që të rekomandohet për mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

(pati një proces të votimit, mirëpo meqë u shpërfaqen disa paqartësi rreth votimit, konkretisht rekomandimit apo jo të kësaj pike të rendit të ditës, sërish kërkohet fjala për sqarime shtesë)

z.Bashkim Sylja, theksoi, është paksa problematike që në seancat e jashtëzakonshme të ndalen pikat e rendit të ditës në KPF ngase qoftë asambleistët qoftë kryetari i Komunës kanë të drejtë të thërrasin seanca të jashtëzakonshme, pastaj ka mundësi që të mos mbahen fare mbledhje të jashtëzakonshme të KPF-së por të shkohet direkt në mbledhje të Kuvendit, kështu që në aspektin ligjor mund të paraqiten telashe nëse ne sot vendosim t'i rrëzojmë këto pika të rendit të ditës dhe të mos i rekomandojmë për shqyrtim në Kuvend.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, në rastin që e ceku parafolësi z.Bashkim Sylja, mua më duket se po i'u mohohet e drejta anëtarëve të kuvendit që të shqyrtojnë këto pika të rendit të ditës sipas thirrjes së mbledhjes, kështu që mendoj se meqë kjo mbledhje dhe mbledhja e Kuvendit janë thirre si të jashtëzakonshme, është mirë të rekomandohen për seancën e Kuvendit dhe aty të shqyrtohen dhe të merren vendime.

z.Naim Çunaku, theksoi, rreth çështjes së ngritur tani, çdo temë që trajtohet në Kuvend dhe ka konotacion financiar, është e obliguar të kaloj përmes KPF-së, cilado qoftë ajo, dhe mendoj se edhe këto pika kanë konotacion apo implikime financiar.

Vërtetë se është situatë jo e këndshme dhe e pranoj atë që u tha se ne nuk kemi të drejtë t'ia cungojmë debatin Kuvendit të Komunës si trupë më e gjerë, andaj në këtë situatë që jemi nuk di çfarë t'ju them për ta zgjidhur këtë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, në të kaluarën, në disa raste ka qenë praktikë që seancat e Kuvendit janë mbajtur pa u mbajtur fare ato të KPF-së.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne të gjithë kemi lexuar ligjet dhe rregullat ligjore rreth këtyre çështjeve, është e paraparë me dispozita ligjore që çdo pikë e rendit të ditës që ka të bëjë me mjete financiare duhet të kaloj për shqyrtim në KPF dhe përmes këtij Komiteti në Kuvend.

Për mbledhje solemne ne nuk mbajmë mbledhje të KPF-së sepse nuk ka të bëjë asgjë me financa apo me çështje tjera që parashihen të shqyrtohen paraprakisht në KPF, mirëpo këto pika të rendit të ditës në këtë mbledhje, patjetër që duhet të kalojnë në seancën e Kuvendit përmes KPF-së, kështu që tani nuk e besoj se mund të shkelim ndonjë procedurë nëse e hedhim sërish në votim që kjo pikë e rendit të ditës të rekomandohet për shqyrtim në Kuvend.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent, 4 vota ishin Për, 4 vota ishin Kundër, mirëpo duke përdorë votën e dyfishtë të Kryesuesit që ishte Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit e caktuar të mbahet më 18.04.2024 sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar.

z.Haki Rudari, theksoi, mendoj se KPF ka të drejtë të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme dhe kjo është praktikë edhe në komunat tjera, të shqyrtoj çështjet dhe në fund të jap rekomandim, mirëpo në të njëjtën kohë nuk mund të ndalen pikat e rendit të ditës që janë për mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit, pra edhe nëse KPF nuk i voton pikat e rendit të ditës, ato nuk mund të ndalen dhe të mos shqyrtohen në mbledhjen e Kuvendit e që në këtë rast nesër mund të vazhdohet me shqyrtimin e tyre nesër në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit.

z.Bashkim Sylja, theksoi, nuk e di sa isha i qartë, unë e potencova që është e mundshme të bëjmë shkelje procedurale të dispozitave ligjore nëse vendosim ne këtu dhe rekomandojmë që këto pika të rendit të ditës të mos rekomandohen për shqyrtim në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit e cila është thirrur për nesër. Pra nuk vendosa unë rreth të drejtës apo jo, por për korrektësi e potencova një gjë të tillë, përndryshe nëse këto pika nuk rekomandohen për Kuvend ato mund aty për aty mund të propozohen dhe të përfshihen si pika të rendit të ditës dhe të shqyrtohen. Pra është një mbledhje e jashtëzakonshme dhe në mbledhje të tilla as nuk mund të shtohen e as hiqen pika të rendit të ditës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, kjo është mbledhje e jashtëzakonshme dhe këtu ndoshta u komplikua paksa kjo çështje, kështu që ju falënderoj për sqarimet. Kjo pikë e rendit të ditës veç përfundoj dhe mund të kalojmë në pikën e dytë.

Drejtoresha e DSHMS znj.Adelinë Stublla, në fjalën hyrëse paraqiti dy pikat e rendit të ditës, mirëpo deri tani u diskutua vetëm për pikën e parë, kështu që kalojmë në pikën e radhës.

2. Propozim Vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës - SHSKUK

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë pikë kemi të bëjmë me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, pra bëhet fjalë për pronën dhe objektin që gjendet në hapësirat e ish Gjimnazit dhe tani SHFMU “Enver Maloku”, objekt i cili kërkohet të kthehet në Poliklinikë Specialistike, ashtu siç e keni parë në materialet e dërguara, mirëpo për më shumë fjalën sërish i’u japim drejtoreshës së DSHMS.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, duke paraqitur këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, ashtu siç e ceku edhe Kryesuesi i Kuvendit, kjo ka të bëjë me çështjen e Spitalit të ashtuquajtur që nga viti 2016 e që faktikisht i’u ka prerë shiriti 3-4 herë, dhe që tani kërkohet t’i ndërrohet destinacioni dhe mbetet në kuadër të Shtëpisë së Shëndetit, kurse objekti për të cilin po diskutojmë e që faktikisht është duke qëndruar kot por që është planifikuar për Urgjencë të Qytetit, do të dedikohet për shërbime specialistike ashtu siç e ceka edhe në fjalimin e mëparshëm për pikën e parë të rendit të ditës.

Pasi që tani Urgjenca po bëhet, kjo mund të themi që është një ndërrim i destinacioneve.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrah këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për mbledhjen e ditës së nesërme.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim edhe këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pa votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se nga 8 anëtarët e KPF-së sa ishin prezent, 4 vota ishin Për, 1 votë ishte Kundër, të tjerët nuk morën pjesë në votim, rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit e caktuar të mbahet më 18.04.2024 sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, Poliklinika Specialistike ndoshta diçka na ndihmon, mirëpo mendoj se ne kuadro kemi sepse jemi në dijeni se qoftë në Prishtinë, qoftë në Vushtrri dhe në vende tjera kemi mjek Llapjan të cilët punojnë, andaj do të ishte mirë të vijnë këtu në Podujevës që është edhe shumë më afër, mirëpo nuk e di sa do të ketë efekt kjo.

Unë në fakt votova Për, që kjo çështje të shkoj në Kuvend për shqyrtim sepse vazhdoj të besoj se Llapi ka mjek dhe staf mjekësor që mund të punojnë në Podujevë e që besoj se DSHMS do të punoj në këtë drejtim.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

**Procesverbalin e mbajtën;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0024934/24
Podujevë,
17 prill 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**